	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 2

Kodi: 050

STANDARDET E FASILITIMIT TË TË NXËNIT

Tipi i Programit: Themelor

Historiku i Programit

Programi “Standardet e fasilitimit të të nxënit” është hartuar nga gjatë realizimit të programit BEP të USAID, dhe është realizuar me sukses që nga viti 2013, me ç’rast janë certifikuar rreth 2000 mësimdhënës të klasave 1-9, për fasilitim të kurseve të ndryshme me bazë në shkollë (siq janë, kursi për lexim, matematikë, shkenca, hulumtim në veprim, zhvillimi profesional me bazë në shkollë, vlerësimi formativ, mësimdhënia e bazuar në projekte, etj.). Që nga viti 2018, përmes programit ASSET të USAID me këtë kurs ka filluar përgatitjen e fasilituesve shkollorë për klasat 10-12, dhe deri tani janë përfshirë rreth 60 mësimdhënës të cilët janë përgatitur për fasilitim të mësimdhënies së bazuar në projekte, dhe vlerësimit formativ. Rëndësia e këtij program trajnues qëndron në faktin se rritja e numrit të fasilituesve shkollorë është identifikimi si nevojë e madhe, sepse zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë po shkon kah organizimi me bazë në shkollë.


Qëllimet e programit:

Ky program ka për qëllim krijimin e kapaciteteve njerëzore në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, fasilituesit (trajnerët) shkollorë, për të kryer organizimin e zhvillimit profesional të kolegëve të tyre në fusha të caktuara. Përmes këtyre kapaciteteve, shkollat do të mbështeten në zbatimin e kurrikulës së re dhe ngritjes së cilësisë në arsim.

Përmbajtja:

Kursi në përmbajtjen e vet ka tetë aktivitete përmes të cilave arrihen rezultatet e pritura:

- Standardet e Praktikave të Fasilituesve Shkollorë – Rishikimi dhe të kuptuarit e Standardeve të Fasilitimit si dhe vendosja e qëllimeve për t’u zhvilluar Profesionalisht në mënyrë që të forcohen shkathtësitë fasilituese.
- Ndikimi i Shkathtësive Relevante – Rishikimi dhe të kuptuarit e natyrës së shkathtësive relevante si dhe ndikimi i tyre në të shpjeguar dhe të mësuarit në Kosovë.
- Barazia Gjinore dhe Fasilitimi – Identifikimi dhe zhvillimi i shkathtësive të nevojshme për të rritur vetëdijen dhe barazimin gjinore në aktivitetet e zhvillimit profesional.
- Portfolio – krijimi i Portfolios si vegël e zhvillimit profesional.
- Arti i të Dëgjuarit & të Pyeturit.-Identifikimi dhe të ushtruarit e shkathtësive konstruktive të dëgjuarit dhe të pyeturit, si dhe reflektimi i rolit të tyre në bashkëpunim me kolegët.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 nga 2

- Mentorimi & Avokimi për Mësimdhënie Kualitative.-Zbulimi se si mentorimi dhe avokimi mund të përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet mësimdhënësve, veçanërisht drejt arritjes së qëllimeve për përmirësim të të nxënit.
- Zgjidhja e Konfliktëve & Krijimi i Ekipeve.- Identifikimi dhe reflektimi në llojet e zgjidhjeve të konfliktëve, dhe pjesëmarrja në aktivitetet e krijimit të ekipit për t'i vërejtur e vlerësuar llojllojshmëritë e punës në ekip.
- Plani i Veprimt.- Përgatitja dhe prezantimi/demonstrimi në grup i një aktiviteti për një takim pune.

Grupi i synuar

Ky program kryesisht u dedikohet mësimdhënësve të cilët aspirojnë të bëhen fasilitues (trajner) shkollorë. Ky kurs zakonisht vijohet si plotësim i një kursi të përmbajtjes (psh. kursi për vlerësim; mësimi i bazuar në projekte; etj.) të cilin kandidati aspirojnë ta fasilitojë. Këta kandidatë janë zakonisht mësimdhënës të përzgjedhur në bazë të përkushtimit më të madh në punë, njohës të mirë të përmbajtjes së kurseve të cilat do ti fasilitojë, njohës të mirë të kurrikulës re, gëzojnë respektin e kolegëve, të gatshëm për t'u angazhuar në organizim të trajnimeve për kolegët e tyre në shkollë, etj. Tendencë është që për çdo fushë mësimore, apo teknike mësimore, shkollat të kenë ekuipe prej së paku dy personave të cilët do të organozojnë zhvillimin profesional të kolegëve të tyre në shkollë, për ta mbështetur zbatimin e kurrikulës së re.

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Programi 'Standardet e fasilitimit të të nxënit' realizohet përmes tri ditëve të plota trajnimi, me gjithsej 24 orë trajnimi.

Vlerësimi/Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen nëse përmbushin kriterin e vijimit të paktën 90% të kohës, dhe vlerësimin pozitiv në bazë të kriterëve të përcaktuara me listen prej 16 standardeve për certifikim të fasilituesve.

Materialet e trajnimit

- Udhëzuesi për fasilitues të programit trajnues së bashku me fletët e punës;
- Sllajdet në Power Point.